

**AD.nr.10/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, U.D. i Kryetarit të Gjykatës Artan Sejrani, me bashkëpunëtorin profesional ....., në çështjen e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit ..... sipas ankesës për inicimin e procedurës disiplinore të parashtruar nga ..... nga Prizreni, me datë 11.10.2021 mori këtë:

### **AKTVENDIM**

**REFUZOHEȚ** si e pa bazuar ankesa e ..... nga Prizreni, për inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit ..... e parashtruar në këtë Gjykatë me datë 17.09.2021.

#### **Arsyetim**

Parashtruesi i ankesës ..... nga Prizreni (në vazhdim ankuesi), me datë 27.08.2021, ka ushtruar kallëzim penal pranë Këshillit Prokurorial të Kosovës ndaj gjyqtarit ....., dhe prokurorit ....., e cila është përcjellë edhe në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Me parashtresën e datës 13.09.2021, (e pranuar në këtë gjykatë me datë 17.09.2021), Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka kërkuar nga kjo gjykatë si autoritet kompetent në këtë rast sipas ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të vlerësojë dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet që i bien në kompetencë të saj lidhur me këtë çështje disiplinore.

Në vazhdim në kallëzimin penale (e cila është trajtuar si ankesë), ndër të tjera theksohet se, pranë kësaj gjykate është çështja penale (pa e cekur se Cila është kjo çështje penale) të cilën është duke e gjykuar gjyqtari ....., i cili më shumë se tri vite po abuzon dhe lënda për fajet e tij ka dështuar, jo një herë, por katër herë, ndërsa vepra është e rëndë dhe duhet të gjykohet. Në këtë çështje penale ankuesi shton se është viktimi pa qenë pjesë e konfliktit, ndërsa gjyqtari ....., i ka liruar kriminelët vrasës dhe për këtë ai është burgosur dy herë, e gjyqtari duke e ditur se nuk ka vepër penale të kryer nga ai dhe se është viktimi, e ai në anën tjetër i ka liruar kriminelin vrasës. Në vazhdim po ashtu ka theksuar se reagimet e gjyqtarit për përjashtimin e tij janë të habitshme, ai po sillet sikur më rëndë po i vjen atij të përjashtohet nga një lëndë, se sa ndonjë mbreti apo ndonjë perandori dhe kjo sjellje e tij tregon lidhshmëri me krimin e organizuar (më gjërësisht sikurse në ankesë)

Gjyqtari ....., me parashtresën e datës 06.10.2021, është deklaruar lidhur me ankesën, duke theksuar se nuk ka bërë kurrfarë shkelje procedurale ndaj këtu ankuesit, me datë 04.05.2018, i është besuar lënda penale PKR.nr.37/2(1)8, në të cilën ankuesi akuzohet për veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 190 par. 2 të KPK-së. Në mes tjerash gjyqtari ka cekur gjithë rrjedhën e procedurës penale e cila është zhvilluar në këtë çështje penale dhe se detyrën e tij e ka kryer konform dispozitave ligjore dhe të gjithë palët i ka trajtuar në mënyrë të barabartë. Lidhur me veprimet në procedurë penale secila palë ka pasur të drejtën e ushtrimit të

ankesës e cila edhe është trajtuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës. Dhe së fundi thekson se kjo çështje penale tani është proceduar për gjykim gjyqtares .....

U.D. Kryetari i Gjykatës pas hetimit paraprak, shikimit në shkresat e lëndës PKR.nr.37/18, analizimit të kërkesës së parashtruesit të ankesës, deklaratën e gjyqtarit, konstaton se anksa është e pa bazuar dhe e njëjtë duhet të **refuzohet si e pa bazuar**.

U.D. Kryetari i gjykatës fillimisht konstaton se ankuesi është i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prizren sipas aktakuzës PP/I.nr.182/17 të datës 02.05.2017, për shkak të veprës penale pjesëmarra në rrahje nga neni 190 par. 2 të KPK-së, si lëndë penale e evidentuar në këtë gjykatë me numër PKR.nr.37/18, e cila fillimisht në punë është ndarë gjyqtarit ....., e cila pastaj është ndarë për gjykim gjyqtares ....., si kryetare e trupit gjykues dhe shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale është në vazhdim e sipër.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore gjeti se të njëjtat nuk qëndrojnë dhe madje nuk janë as objekt i shqyrtimit nga Kryetari i Gjykatës si autoritet kompetent, në të vërtet vihet në dukje se në ankesën disiplinore janë shprehur pakënaqësi lidhur me rrjedhën e procedurës penale dhe kundër vendimeve të cilat janë marrë deri më tani. Në ankesë nuk është përmendur ndonjë rrethanë apo shkelje e caktuar nga gjyqtari ....., ashtu siç kërcohët edhe me dispozitat ligjor në fuqi të **Ligjit nr. 06/1 - 057** për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në ankesë nuk është bërë një përshkrim konciz i aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur dyshimi për shkelje disiplinore kundër gjyqtarit në fjalë. Nuk ka pasur neglizhencë në punën gjyqtarit, për më tepër gjyqtari është i pavarur në marrjen e vendimeve, lidhur me rastin ka ndërmarrë veprime procedurale konform dispozitave ligjore dhe të cilat vendime janë shqyrtuar nga gjykatat e shkallëve më të larta sipas mjetit juridik.

Së këndejmi, U.D. i Kryetarit të gjykatës, konsideron se anksa e parashtruesit për gjyqtarin ....., duhet të refuzohet si e pa bazuar, pasi që nuk ka mundur të gjejë se ka bërë Shkelje të detyrave apo sjelljeve të gjyqtarit.

Andaj, siç u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 9 par.6 lidhur me nenin 17 par.5 të Ligjit nr. 06/1 - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

### GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN

AD.nr.10/2021 datë 11.10.2021



Kundër këtij aktvendimi nuk parashihet e drejta e ankesës.